



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE

UDHËZIM

Nr. 08 Date 30 .12.2013

**MBI ZBATIMIN NË PRAKTIKË TË TAKSËS SË AMBALAZHIT TË PLASTIKËS DHE QELQIT**

Ne zbatim te ligjit nr. 9975, date 28.07.2008 "Per Taksat Kombetare" te ndryshuar"; udhezimit nr. 26, date 04.09.2008 te Ministrit te Financave "Per Taksat Kombetare", te ndryshuar";

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave

UDHËZON:

1. "TAM" është shkurtimi i taksës së ambalazhit dhe shfaqet në kutinë 47 të DAV.
2. Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë të klasifikuara në krerët 3923 dhe 7010 të NK-së (pra ka edhe ambalazh plastik bosh edhe ambalazh qelqi bosh), apo mall i cili është i ambalazhuar një pjesë në ambalazh plastik dhe një pjesë në ambalazh qelqi, atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS); llogaritja e taksës për çdo artikull është sipas kodit të paketimit përkatës;
3. Kodet e paketimit që do të përdoren në kutinë 31 të DAV për qëllime të aplikimit të TAM janë:

**Për plastikën:**

- Kodi 71 Mallra në ambalazh plastik, përveçse në paleta
- Kodi 74 Ambalazh plastik bosh
- Kodi 83 Ambalazh plastik që nuk paguan
- Kodi 100 Mallra në ambalazh plastik dhe në paleta

**Për qelqin:**

- Kodi 72 Mallra në ambalazh qelqi, përveçse në paleta
- Kodi 75 Ambalazh qelqi bosh
- Kodi 84 Ambalazh qelqi që nuk paguan
- Kodi 110 Mallra në ambalazh qelqi dhe në paleta

4. **Kodi i paketimit 71** do të përdoret në rastin e importeve të mallrave të cilat janë të ambalazuara më ambalazh plastik (i cili përbën të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit) dhe nuk ndodhen në paleta.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall (psh qumësht) i cili është i ambalazhuar në bidona plastike të cilat nuk janë të vendosura në paleta, atëhere do të përdoret kodi i paketimit 71 dhe mbi peshën e ambalazhit (diferenca e peshës bruto me ate neto) do të aplikohet taksimi 100 leke/kg.*

5. **Kodi i paketimit 74** do të përdoret në rastin e importimit të mallrave të cilat klasifikohen në kreun 3923 të Nomenklaturës së Mallrave.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall i cili klasifikohet në kreun 3923, (si psh: pipeta plastike, shishe plastike, etj) atëhere do të përdoret kodi i paketimit 74 dhe mbi peshën neto të mallit do të aplikohet niveli i taksimit 100 lekë/kg.*

6. **Kodi i paketimit 83** do të përdoret në rastin e importimit të ambalazheve bosh apo mallrave të ambalazuara në ambalazh plastik të cilat janë të përjashtuara nga taksa e ambalazhit plastik.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall i cili klasifikohet në kreun 3923, (si psh: bidona plastike > se 20 litra, apo kapakë të CD-ve) apo një mall i ambalazhuar me ambalazh plastik (si psh: peshk i vendosur në arka) të cilat janë të përjashtuara nga pagesa e kësaj takse, atëhere do të përdoret kodi i paketimit 83 dhe malli apo ambalazhi i mallit nuk do të taksohet.*

7. **Kodi i paketimit 100** do të përdoret në rastin e importeve të mallrave të cilat janë të ambalazuara në ambalazh plastik që përbën mbi 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit, por që ndodhet në paleta.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall (si psh: qumësht) i cili është i ambalazhuar në bidona plastike të cilat janë të vendosura në paleta, atëhere do të përdoret kodi i paketimit 100 dhe mbi peshën e ambalazhit (pasi t'i jetë zbritur pesha e paletave) do të aplikohet niveli i taksës 100 lekë/kg.*

8. **Kodi i paketimit 72** do të përdoret në rastin e importeve të mallrave të cilat janë të ambalazuara më ambalazh qelqi (i cili përbën të paktën 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit) dhe nuk ndodhen në paleta.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall (psh qumësht) i cili është i ambalazhuar në shishe qelqi të cilat nuk janë të vendosura në paleta, atëhere do të përdoret kodi i paketimit 72 dhe mbi peshën e ambalazhit (diferenca e peshës bruto me ate neto) do të aplikohet taksimi 10 leke/kg.*

9. **Kodi i paketimit 75** do të përdoret në rastin e importimit të mallrave të cilat klasifikohen në kreun 7010 të Nomenklaturës së Mallrave.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall i cili klasifikohet në kreun 7010, (si psh: shishe qelqi, etj) atëhere do të përdoret kodi i paketimit 75 dhe mbi peshën neto të mallit do të aplikohet niveli i taksimit 10 lekë/kg.*

10. **Kodi i paketimit 84** do të përdoret në rastin e importimit të ambalazheve bosh apo mallrave të ambalazuara në ambalazh qelqi të cilat janë të përjashtuara nga taksa e ambalazhit të qelqit.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall i cili klasifikohet në kreun 7010, (si psh: ampula për barna mjekësore) apo një mall i ambalazhuar me ambalazh qelqi (si psh: serum në shishe qelqi) të cilat janë të përjashtuara nga pagesa e kësaj takse, atëhere do të përdoret kodi i paketimit 84 dhe malli apo ambalazhi i mallit nuk do të taksohet.*

11. **Kodi i paketimit 110** do të përdoret në rastin e importeve të mallrave të cilat janë të ambalazuara në ambalazh qelqi që përbën mbi 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit, por që ndodhet në paleta.

*Shembull: "Në rast se në import paraqitet një mall (si psh: qumësht) i cili është i ambalazhuar në shishe qelqi të cilat janë të vendosura në paleta, atëhere do të përdoret kodi i paketimit 110 dhe mbi peshën e ambalazhit (pasi t'i jetë zbritur pesha e paletave) do të aplikohet niveli i taksës 10 lekë/kg.*

12. Natyrisht që në import mund të paraqiten raste që nuk janë të parashikuara në shembujt e mësipërme. Gjithsesi parimi i deklaramit në këto raste është përdorimi i BIS, duke përdorur kodet përkatëse të paketimit të kutisë 31 të DAV.

13. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë

**Elisa SPIROPALI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**